Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 104/22
Datë/Datum. 21.04.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

104/ 22

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 111 paragrafi 1 pika 10 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenin 10 pika (j) pika 1.10 të ***Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave*** , si dhe neni 13 pika 7 dhe 8 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020,me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së "Fikret Ahmeri" me Seli në Prishtinë, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit me titull "Angazhimi i eksperteve të çështjeve të caktuara për shërbime konsulentë përmes Marrëveshjeve për shërbime te veçanta (konsulentë individ) për nevoja te Ministrisë se Kulturës, Rinisë dhe Sportit ne pajtim me Rregullat për prokurim te shërbimeve të veçanta (konsulent kontraktohet individual) te lëshuar nga KRPP me datë 18.11.2020 (për vitin 2022) " me numër te prokurimi "207-22-437-2-1-1" iniciuar nga AK-MKRS dhe ÇJK, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 19 PRILL 2022 mori ketë :

VENDIM

I. **Hedhet si e pa lejuar** **ankesa e parashtruar nga OE** "Fikret Ahmeti" për aktivitetin e prokurimit me titull " Angazhimi i eksperteve të çështjeve të caktuara

për shërbime konsulentë përmes Marrëveshjeve për shërbime te veçanta (konsulentë individ) për nevoja te Ministrisë se Kulturës, Rinisë dhe Sportit ne pajtim me Rregullat për prokurim te shërbimeve të veçanta (konsulent kontraktohet individual) te lëshuar nga KRPP me datë 18.11.2020 (për vitin 2022) " me numër te prokurimit "207-22-437-2-1-1" iniciuar nga AK- MKRS dhe ÇJK.

II. **I LEJOHET** autoritetit kontraktues – MKRS dhe ÇJK, që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull "Angazhimi i eksperteve të çështjeve të caktuara për shërbime konsulentë përmes Marrëveshjeve për shërbime te veçanta (konsulentë individ) për nevoja te Ministrisë se Kulturës, Rinisë dhe Sportit ne pajtim me Rregullat për prokurim te shërbimeve të veçanta (konsulent kontraktohet individual) te lëshuar nga KRPP me datë 18.11.2020 (për vitin 2022) " me numër te prokurimit "207-22-437-2-1-1" , (përkitazi me ketë ankesë nëse nuk ka ankesë tjetër).

A R S Y E T I M

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë: 15..04.2022, ka pranuar ankesë nga "Fikret Ahmeti" Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit me titull " Angazhimi i eksperteve të çështjeve të caktuara për shërbime konsulentë përmes Marrëveshjeve për shërbime te veçanta (konsulentë individ) për nevoja te Ministrisë se Kulturës, Rinisë dhe Sportit ne pajtim me Rregullat për prokurim te shërbimeve të veçanta (konsulent kontraktohet individual) te lëshuar nga KRPP me datë 18.11.2020 (për vitin 2022) " me numër te prokurimi "207-22-437-2-1-1" iniciuar nga AK- MKRS dhe ÇJK

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se për aktivitetin e prokurimit në fjalë autoriteti kontraktues MKRS dhe ÇJK, ka publikuar Njoftimin për kontratë me datë: 04.02.2022 ,hapja e ofertave është parapare të jetë me dt.10.03.2022.

Njoftimi i vendimit te AK-së dhe Letra standarde janë te dt.12.04.2022.

Në E-prokurim dhe në ankesë të OE nuk figuron kërkesa për rishqyrtim. Kërkesa për

rishqyrtim nga OE- ankues nuk është parashtruar gjë që as vendim nga AK- MKRS dhe ÇJK nuk ka.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron, se meqë, "Fikret Ahmeti" Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit me titull " Angazhimi i eksperteve të çështjeve të caktuara për shërbime konsulentë përmes Marrëveshjeve për shërbime te veçanta (konsulentë individ) për nevoja te Ministrisë se Kulturës, Rinisë dhe Sportit ne pajtim me Rregullat për prokurim te shërbimeve të veçanta (konsulent kontraktohet individual) te lëshuar nga KRPP me datë 18.11.2020 (për vitin 2022) " me numër te prokurimi "207-22-437-2-1-1" iniciuar nga AK- MKRS dhe ÇJK, nuk e kanë paguar tarifën e ankesës së tyre të datës: 15.04.2022 me numër të protokollit 104/2022 , OSHP-ja me datën: 15.04.2022, ka dërguar e-mail tek OE ankues duke i rekomanduar që të kompletojnë ankesën e tyre me tarifën e ankesës dhe me shkresat tjera në mënyrë që ankesa e tyre të kompletohet dhe të procedohet me tutje, po ashtu zyrtaret përgjegjës për pranimin e ankesave kanë kontaktuar edhe me telefon me përfaqësuesit e OE ankues për ti sqaruar se ankesa e tyre nuk është kompletuar , te njëjtës ankese i mungon tarifa e ankesës, kërkesë për rishqyrtim dhe vendimi i AK-së, në kërkesën për rishqyrtim, mirëpo deri me sot datë: 20.04.2022, OSHP nuk ka pranuar asnjë përgjigje për plotësim të ankesës në fjalë nga ana e OE ankues.
OSHP-ja, gjithashtu është siguruar nga Zyrtarja për të Hyra në OSHP, që në sistemin e të hyrave të pagesave nga Thesari nuk ekziston pagesa e bere nga OE-ankues për ankesën në fjalë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit duke u bazuar në sqarimet dhe verifikimet e cekura si më lart konstaton se OE "Fikret Ahmeti" Prishtinë nuk e ka kompletuar ankesën tyre duke mos bere fare pagesën e tarifës së ankesës, dhe dështmitë tjera të cekura si më lart andaj ankesa e datës 15.04.2022 me numër të protokollit 104/2022, nuk hyn në shqyrtim .

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se ankesa e "Fikret Ahmeti" Prishtinë e datës: 15.04.2022 me numër të protokollit 104/2022, për të hyrë në shqyrtim konform nenit 11 paragrafit 1 pika 10 të LPP-së, do të duhej të jetë e kompletuar edhe me dështminë e pagesës së tarifës së ankesës , të përmendur në nenin 118 të këtij ligji.
Po ashtu edhe neni 13 pika 7 dhe 8 e Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020,me numër të protokollit 83/2020, specifikon: Të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP, konform nenit 14 të F03 të legjislacionit dytësor te KRPP-së në vlerën prej:

7.1 Kurdo që ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

7.2 Kurdo që ankesa ndërlidhet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

8. Pagesa do të bëhet në llogarinë e krijuar nga OSHP-ja. Fatura për pagesën e tarifës mund të merren në zyrat e OSHP-së, si dhe në platformën e prokurimit elektronik.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar nga OE "Fikret Ahmeti" Prishtinë e datës 15.04.2022, me numër të protokollit 104/2022, hedhet si e pa lejuar dhe nuk hyn në shqyrtim sepse ankuesi nuk e ka paguar fare tarifën e sigurimit të ankesës, ashtu siç kërkohet me nenin 111 paragrafi 1 pika 10 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, nenin 10 pika (j) pika 1.10 të ***Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave*** , si dhe neni 13 pika 7 dhe 8 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020,me numër të protokollit 83/2020.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi Sekretariatit të OSHP-së

Ardian BEHRA

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK MKRS dhe ÇJK
1x1 OE "Fikret Ahmeti" Prishtinë
1x1 Arhivës së OSHP-së
1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së